




Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	15.03.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKIPESHK	1387/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.99/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.99/2022 të datës 308.02.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rruga [redacted] në Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 15/03/2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.99/2022 e datës 08.02.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën “Teknik në Mirëmbajtjen e Rrugëve” sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 17.12.2014 në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datën 04.11.2021 ka parashtruar kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm për harmonizim të koeficientit me pozita të njëjta, ndërsa më datë 07.12.2021 ka ripërsëritur kërkesën tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ankuesi meqenëse nuk ka marrë përgjigje, nga Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 08.02.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:591/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimor për ngritje të koeficientit nga 5 në 6.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 14.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa me datën 22.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër A.nr.99/2022 me numër të protokollit 591/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 08.02.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 07.12.2021 e parashtruar nga ankuesi; Kërkesën e datës 04.11.2021 e parashtruar nga ankuesi; Kërkesë për ngritje të koeficientit e datës 02.08.2013 dhe 19.10.2017 të parashtruara nga ankuesi; Kërkesë për avancim në pozitë e datës 24.03.2017 e parashtruar nga ankuesi; Certifikatën e datës 30.01.2017 e lëshuar nga Kolegji Evropian i Kosovës ;Kërkesa për avancim e datës 26.11.2014; Vendimin e datës 16.12.2014 për transferim; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të emërimit i datës 17.12.2014; Diplomën e datës 20.09.2017 me nr.016/2017 e lëshuar nga Kolegji Evropian i Kosovës; Shpalljen e rekrutimit për Teknik; Çertifikatë e datës 14.03.2015; Çertifikatë e datës 27.12.2014; Çertifikatë e datës 13.12.2014; Kërkesë për caktimin e ankuesit në asistencë në Autostradë e datës 15.08.2018; Përgjigje në ankesë e datës 22.02.2022 me numër protokollit 930/2022 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës dhe Kërkesën e datës 12.06.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që ti bëhet ngritja e koeficientit nga pesë (5) në koeficientin gjashtë (6).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Ndryshim Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 17.12.2014 i është përcaktuar koeficienti pesë (5), si rrjedhojë tek rasti i ankuesit nuk kemi asnjë akt administrativ nga Zyrtari më i Lartë Administrativ i institucionit me të cilën i është ngritur koeficienti, po ashtu nuk është dëshmuar me asnjë provë që institucioni ka buxhet për realizimin e ngritjes së koeficientit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se neni 7 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili përcakton: *“Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financat”,* rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ligjërisht ngritja e koeficienteve për nëpunësit civil, mund të bëhet vetëm nëpërmjet procedurave ligjore e që duhet të



dëshmohet se institucioni ka planifikuar mjete buxhetore të miratuara nga ministria përgjegjëse për administratë publike respektivisht ministria përgjegjëse për financa, kështu përderisa nuk ka planifikim buxhetit apo nuk ka kërkesë nga institucioni ku nëpunësi civil është duke e ushtruar pozitën tek institucionet gjegjëse, dhe kur nuk plotësohen kushtet e tilla ligjore nëpunësi civil paguhet me pagë siç është përcaktuar në aktin e emërimit me të cilin ka themeluar marrëdhënien e tij të punës, siç parashihet me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 9 paragrafin 1 përcakton se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.99/2022, datë 15/03/2022

Sabile AVDYLI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit,
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- ❖ Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

